



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.11, datë 28/03/2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR SHFRYTËZIMIN E MATERIALEVE
INERTE OË NXIRREN NGA SHTRATI I LUMIT FAN DHE MAT,
SUBJEKTIT “4A-M” SH.P.K**

Në mbështetje të shkronjës të pikës 2 të nenit 50 , të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar , vendimit nr.550 datë, 15.07.2020 ““Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje,veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese,të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, sidhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit me nr.1 prot., datë 7.7.2011, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit nr.2 prot., datë 27.7.2012, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I.

1. Miratimin e lejes për shfrytëzimin e materialeve inerte, subjektit “4A-M” sh.p.k. për zbatimin e Kontratës “Ndërtimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri - Loti 2”, me vendndodhje, në shtratin e lumit Fan dhe Mat, Bashkia Mirditë dhe Lezhë, Qarku Lezhë sipas këtyre koordinatave në sistemin KRRGJSH:

2. Treguesit paraprak të shfrytëzimit janë:

Zona “1” e shfrytëzimit në lumin Fan në sistemin KRRGJSH:

| | | |
|---------------|----------------|-----------------|
| X1 = 479910.8 | Y1 = 4618698.8 | Z1 = 16 m.m.n.d |
| X2 = 479916.6 | Y2 = 4618548.9 | Z2 = 17 m.m.n.d |
| X3 = 478969.7 | Y3 = 4618886.9 | Z3 = 18 m.m.n.d |
| X4 = 478824.6 | Y4 = 4618920.2 | Z4 = 19 m.m.n.d |
| X4 = 478966.0 | Y4 = 4619036.5 | Z4 = 21 m.m.n.d |
| X4 = 479350.4 | Y4 = 4618962.5 | Z4 = 20 m.m.n.d |

Zona “2” e shfrytëzimit në lumin Mat në sistemin KRRGJSH:

| | | |
|---------------|----------------|-----------------|
| X1 = 481652.7 | Y1 = 4621195.9 | Z1 = 29 m.m.n.d |
| X2 = 481326.4 | Y2 = 4621222.1 | Z2 = 28 m.m.n.d |
| X3 = 481753.2 | Y3 = 4621929.0 | Z3 = 24 m.m.n.d |
| X4 = 481479.9 | Y4 = 4621929.0 | Z4 = 25 m.m.n.d |

3. Sasia e dhënë në përdorim për të gjithë periudhën e lejes është jo më shumë se 120,000 m³;
4. Subjekti të respektojë të gjitha sygjerimet e dhëna nga AKM-ja dhe SHGJSH-ja;
5. Subjekti duhet të raportojë çdo muaj pranë ZABU Ishëm-Erzen-Mat për volumin e materialit të nxjerr nga shtrati;
6. Të ndiqet nga ZABU Ishëm-Erzen-Mat zbatimi i projektit të rehabilitimit;
7. Të mos depozitohet material stok në brigjet e shtratit pas përfundimit të kësaj leje;
8. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin ekëtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBI MAT

GJERGJ PRENDI

